

Nr. Regj. 24120/2012

OPK/DMP

03-3889/12

02

30.10.2012

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, gjyqtaria Azra Cakolli me pjesmarjen e sekretarës juridike Shemsije Lumi, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Kujtim(Muhamet)Kërveshi, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, Nr. 04/L-050, në bazë të nenit 73, 74, 195, 199 dhe 198 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet(LK) GZ KSAK 23/79, më datë 22.10.2012 morri këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET: Procedura për kundërvajtje ndaj **Kujtim(Muhamet)Kërveshi**, i lindur më 06.07.1981 në Pejë, me vendbanim në rrugën "Ganimete Tërbeshi", nr.19/16, në Prishtinë, ka kryer fakultetin e juridik, Anëtarë i Jashtëm në Këshillin Prokurial të Kosovës, për kundërvajtjen nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, konform nenit 198 paragrafi 1 pika 8 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, për shkak se nuk ka prova se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë. Shpenzime të procedurës nuk ka pasur.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet palës dhe parashtresit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsion në Prishtinë, i parashtroi kësaj gjykate kërkesën Nr. 01-2159/2012 me datë 27.06.2012 për fillimin e procedurës për kundërvajtje ndaj të pandehurit Kujtim Kërveshit, nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2 ndëshkuar me nenin 17 paragrafi 1 pika 1 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarve të lartë publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë personat Zyrtarë, me të cilën kërkesë i vihet në barrë se në Agjencinë Kundër Korrupsion, nuk e ka dorëzuar formularin mbi deklarin e rregullt vjetor të pasurisë deri më datën 31 mars të vitit 2012. Gjyqtaria filloi procedurën kundërvajtëse me marrjen në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se Anëtarë i Jashtëm në Këshillin Prokurial të Kosovës është bërë në muajin maj 2011 dhe e ligjin e vjetër nuk ka qenë i obligur ta deklaronte pasurinë, më herët në funksione të tjera në Agjencion ka deklaruar pasurinë dhe se qëllimi nuk ka qenë ikja nga obligimi i tillë mirpo pika kontaktuese nuk e ka informuar se ai si anëtar i jashtë duhet ta deklaronte pasurinë duke propozuar që të dëgjohet në cilësinë e dëshmitarit Sadri Krasniqi. Gjykatës ia prezanton Vërtetimin nr. 03/3812 të datës 23.10.2012.

Për vërtetimin e gjendjes faktike gjyqtaria ftoi Sadri Krasniqin, menaxher i burimeve njerëzore në sekretariatit e zyrës së Kryeprokurorit të shtetit i cili deklaroi se zyrtaria për burime njerëzore Violeta Neziri e ka dërguar listën e personave të zyrtarëve të lartë publik dhe këtë e ka bërë më datë 22.02.2012. Pasi që Anëtarët e Jashtëm në Këshillin Prokurial të Kosovës janë të angazhuar nga shoqëria civile e të cilët nuk kanë themeluar marrdhënie pune në Këshillin Prokurial zyrtaria ka biseduar me dikë të Agjencionit i cili sipas saj i ka thënë se ata do të miren me këta anëtar andaj ajo nuk i ka informuar. Gjykatës ia ka prezentuar provën se janë të informuar të gjithë të tjerët pos anëtarve të jashtëm dhe se sikurse që janë informuar këta do ti kishte informuar dhe anëtarët por ka qenë një keqkuptim në mes të zyrtarës dhe personave kompetent të agjencisë kundër korrupsion. Poashtu u dëgjua dhe përfaqësuesi i Agjencisë kundër Korrupsion Agron Behrami, i cili deklaroi

03-3889/12/02
Sung


se Violeta Nezirit nuk i kanë thënë diçka të këtill dhe se e njeta është dasht ti informoi këta persona për deklarim të pasurisë.

-2-

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi të deklaratës së të pandehurit, dëgjimi i dëshmitarit Sadri Krasniqi, deklarata e përfaqësuesit të Agjencisë kundër Korrupsion Agron Behramit, vlerësimi të shkresave të tjera të lëndës, gjyqtarja ka konstatuar se i pandehuri nga pika kontaktuese nuk ka qenë i informuar se duhet ta deklaoi pasurinë andaj konstatoi se nuk ka kryer kundërvajtjen dhe në vështrim të nenit 198 par. 1 pika 8 të LK, **pezulloi** procedurën për kundërvajtje në mungesë të provave.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr. Regj. 24120/2012, datë 22.10.2012



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nga data e pranimi të njëjtit nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.